

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa


Tremujori II, 2023

Tiranë, më 04 Shtator 2023: Indeksi i Kushtimit në Ndërtim, në tremujorin e dytë 2023 arriti 112,8 kundrejt tremujorit të katërt 2020 si periudha bazë. Ndryshimi vjetor i Indeksit të Kushtimit në Ndërtim në tremujorin e dytë 2023 është 4,7 %, një vit më parë ky ndryshim ishte 6,2 %.

Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shpenzime materiale” me 5,4 %, pasuar nga grupet “Shpenzime energjie” me 5,0 %, “Shpenzime për paga” me 4,9 %, “Kosto të tjera” me 4,6 %, “Shpenzime transporti” me 4,0 % dhe “Shpenzime makinerie” me 2,9 %.

Brenda grupit “Shpenzime materiale”, indekset e nëngrupit “Materiale hidro-sanitare dhe ventilimi” shënuan rritjen më të lartë me 5,8 %, pasuar nga grupi “Materiale ndërtimi” me 5,5 % dhe “Materiale elektrike dhe komunikimi” me 4,3 %.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa



Ndryshimet tremujore të grupeve kryesore: Indeksi i Kushtimit në Ndërtim shënoi rritje me 1,1 % krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2023. Rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Shpenzime energjie” me 2,2 %, pasuar nga grupet “Shpenzime për paga” me 1,3 %, “Shpenzime materiale” me 1,0 %, “Shpenzime transporti” me 0,9 %, “Shpenzime makinerie” dhe “Kosto të tjera” me 0,5 % secila.

Për publikim 04/09/2023

Tab. 1 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim për Banesa

Tremujori i katërt 2020=100

Kodi	Grupet	Peshat	II-20	III-20	IV-20	I-21	II-21	III-21	IV-21	I-22	II-22	III-22	IV-22	I-23	II-23
	Totali (1+2+3+4+5+6)	100,0	100,2	99,9	100,0	100,9	101,5	102,1	103,1	106,0	107,8	109,4	110,3	111,6	112,8
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	47,6	99,8	99,8	100,0	100,9	101,8	102,7	104,1	107,0	108,6	110,9	112,3	113,3	114,4
	a. Materiale ndërtimi	34,9	99,8	99,8	100,0	100,8	102,0	102,8	104,1	107,4	109,0	111,2	112,9	113,8	115,0
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	7,8	99,9	100,0	100,0	101,6	102,1	102,9	104,1	105,2	106,9	109,3	110,3	110,6	111,5
	c. Materiale hidro-sanitare	4,9	99,8	99,9	100,0	100,0	100,6	102,0	103,6	106,8	108,5	110,9	111,7	113,4	114,8
2	Shpenzime për paga	22,3	100,2	99,9	100,0	101,8	102,2	102,0	102,9	104,4	105,2	106,7	108,0	109,0	110,4
3	Shpenzime makinerie	12,7	99,4	99,3	100,0	99,2	99,7	100,8	100,6	103,0	103,8	105,2	105,9	106,3	106,8
4	Shpenzime transporti	8,4	101,7	100,8	100,0	101,9	103,1	102,8	104,5	104,0	104,4	105,2	106,5	107,6	108,5
5	Shpenzime për energji	3,3	100,0	100,0	100,0	100,0	100,0	101,4	101,5	111,7	115,5	117,1	115,9	118,7	121,3
6	Kosto të tjera	5,8	100,6	99,7	100,0	102,2	102,4	102,1	103,1	105,8	109,3	110,1	111,2	113,7	114,3

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa

%

Kodi	Grupet	II-20/II-19	III-20/III-19	IV-20/IV-19	I-21/I-20	II-21/II-20	III-21/III-20	IV-21/IV-20	I-22/I-21	II-22/II-21	III-22/III-21	IV-22/IV-21	I-23/I-22	II-23/II-22
	Totali (1+2+3+4+5+6)	0,4	0,2	-0,1	0,6	1,3	2,2	3,1	5,0	6,2	7,2	7,0	5,3	4,7
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	-1,2	-1,0	-0,8	0,3	2,0	2,9	4,1	6,0	6,6	8,0	7,9	5,9	5,4
	a. Materiale ndërtimi	-1,6	-1,3	-1,1	0,0	2,2	3,0	4,1	6,5	6,9	8,2	8,4	6,0	5,5
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	-0,5	-0,9	-1,0	1,5	2,2	2,9	4,1	3,5	4,7	6,2	5,9	5,2	4,3
	c. Materiale hidro-sanitare	1,1	1,3	1,5	1,0	0,8	2,1	3,6	6,8	7,8	8,8	7,8	6,2	5,8
2	Shpenzime për paga	-1,0	-1,9	-2,1	0,5	2,0	2,1	2,9	2,5	2,9	4,6	5,0	4,4	4,9
3	Shpenzime makinerie	1,0	1,0	0,8	0,8	0,3	1,4	0,6	3,8	4,1	4,4	5,3	3,2	2,9
4	Shpenzime transporti	1,7	1,7	-0,7	0,4	1,4	2,0	4,5	2,1	1,2	2,3	1,9	3,5	4,0
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	1,4	1,5	11,7	15,5	15,5	14,1	6,3	5,0
6	Kosto të tjera	1,9	1,4	1,6	0,9	1,8	2,4	3,1	3,5	6,7	7,9	7,9	7,5	4,6

Tab. 3 Ndryshimet tremujore të Indeksit të Kushtimit në Ndërtim për Banesa

%

Kodi	Grupet	II-20/II-20	III-20/II-20	IV-20/III-20	I-21/IV-20	II-21/I-21	III-21/II-21	IV-21/III-21	I-22/IV-21	II-22/II-22	III-22/II-22	IV-22/III-22	I-23/IV-22	II-23/I-23
	Totali (1+2+3+4+5+6)	-0,1	-0,3	0,1	0,9	0,6	0,6	1,0	2,9	1,7	1,5	0,8	1,2	1,1
1	Shpenzime materiale (a+b+c)	-0,7	0,0	0,2	0,9	0,9	0,9	1,3	2,8	1,5	2,1	1,3	0,8	1,0
	a. Materiale ndërtimi	-1,1	0,0	0,2	0,8	1,1	0,8	1,3	3,1	1,5	2,1	1,5	0,8	1,1
	b. Materiale elektrike dhe komunikimi	-0,2	0,1	0,0	1,6	0,5	0,8	1,1	1,0	1,6	2,2	0,9	0,3	0,8
	c. Materiale hidro-sanitare	0,7	0,1	0,1	0,0	0,5	1,4	1,6	3,1	1,5	2,2	0,8	1,5	1,2
2	Shpenzime për paga	-1,1	-0,3	0,1	1,8	0,4	-0,3	0,9	1,4	0,8	1,4	1,3	0,9	1,3
3	Shpenzime makinerie	1,0	-0,1	0,7	-0,8	0,5	1,1	-0,2	2,5	0,7	1,4	0,7	0,4	0,5
4	Shpenzime transporti	0,2	-0,9	-0,8	1,9	1,3	-0,3	1,6	-0,5	0,4	0,7	1,3	1,0	0,9
5	Shpenzime për energji	0,0	0,0	0,0	0,0	0,1	1,3	0,1	10,0	3,4	1,4	-1,0	2,5	2,2
6	Kosto të tjera	-0,7	-0,9	0,3	2,2	0,2	-0,3	1,0	2,7	3,3	0,7	1,0	2,3	0,5

Metodologjia

Indeksi i Kushtimit në Ndërtim (për Banesa) (IKN) mat ecurinë e çmimeve të materialeve të ndërtimit, të fuqisë punëtore dhe të shpenzimeve të tjera kapitale që përdoren në ndërtimin e një banese tip (8 – 10 kate). IKN është një tregues i rëndësishëm ekonomik për sektorin e ndërtimit. Indeksi përdoret si deflator për llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto dhe Indekseve të ndryshme të volumit, përdoret nga Institucionet Qeveritare, Banka Qendrore e Shqipërisë, Organizata të tjera joqeveritare, Banka Botërore, FMN etj. Peshat e shportës së materialeve janë llogaritur duke u bazuar në preventivat e shpenzimeve për ndërtimin e një banese shumëkatëshe marrë nga firmat e ndërtimit. Tremujori i katërt i vitit 2020 shërben si periudhë bazë për llogaritjen e indeksit (tremujori i katërt 2020=100). Shporta e re përbëhet nga 71 zëra nga të cilat 66 janë materiale ndërtimi. Çmimet për materialet e ndërtimit mbledhen nga 225 distributorë dhe shitës me shumicë të materialeve të ndërtimit. Ndërsa, të dhënat për shpenzimet për pagat, makineritë dhe transportin merren nga 96 ndërmarrje të mëdha ndërtimi të përqëndruara kryesisht në rrethin e Tiranës. Zgjedhja e ndërmarrjeve është bërë në bazë të volumit të ndërtimit që ato realizojnë gjatë një periudhe një vjeçare. Shpenzimet janë klasifikuar në përputhje me klasifikimin që përdor EUROSTAT për Indeksin e Kushtimit në Ndërtim, në gjashtë grupe kryesore si më poshtë:

- Shpenzime për materiale
- Shpenzime për paga
- Shpenzime për makineri
- Shpenzime transporti
- Shpenzime për energji
- Shpenzime të tjera

Rishikimi

Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike, ndryshimi i periudhës bazë etj.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Ndryshimi tremujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të tremujorit korrent me tremujorin e mëparshëm.